



Pranuar / Doretuar Punëpunësi/Prodato Received/Delivered	14.10.2022	2	viti god year
Organ / Shënjë Organi / Jednica Org / Unit	SKPM/SHK	6232/2022	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.713/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.713/2022 të datës 18.08.2022, të parashtruar nga ankuesi nga Gjakova, kundër Vendimit me Numër 01-116/02-19210 të datës 29.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.713/2022 e datës 18.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me Numër 01-116/02-19210 i datës 29.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës.*

III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjakovës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Inspektoratit të Agjencisë së Regjistrimit Civil më datë 23.06.2022 ka njoftuar Udhëheqësen e Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës që pas inspektimit të jashtëzakonshëm në Zyrën e Gjendjes Civile në Brekoc, ku pas inspektimit është konstatuar se personi [redacted] i cili figuron në një libër Amëz të lindjes së veçantë dhe i njëjti është regjistruar në sistemin elektronik nga zyrtar [redacted] në kundërshtim me rregullat në fuqi.

Pas kësaj shkrese Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës, më datë 28.06.2022 ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me numër 01-116/01-16405 pranë Komisionit Disiplinor duke konstatuar që ankuesi më regjistrimin në sistemin elektronik të qytetari [redacted] dhe krijimit të numrit personal është shkelur Ligji i Gjendjes Civile dhe Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin e Mëvonshmen në regjistrat e gjendjes civile, me këto veprime ka shkelur nenin 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës, më datë 29.07.2022 ka nxjerr Vendim me numër 01-116/02-19210 përmes të cilit aneksit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim 20% të pagës për periudhën dy mujore".

Ankuesi kundër këtij vendimi, përmes postës më datë 16.08.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 18.08.2022 është regjistruar nën shenjen A.nr.713/2022 dhe me Nr. Prto:4783.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës. Ndërsa Këshilli më datë 16.09.2022 kemi pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4783/2022 të datës 18.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Numër 01-116/02-19210 i datës 29./07/2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës; Vendimin me Nr. 05/134 të datës 01.03.2017 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Regjistrin e shtetasve; Deklaratë Noteriale nën Betim LRP Nr. Rendor 4509/2017; Faturë në emër të Letërnjoftimin e [redacted] Deklaratën Betimi nga [redacted] e datës 27.05.2017; Certifikatë e lindjes e datës 12.09.2006 për [redacted] Pasaportë për [redacted] e lëshuar nga Mbretëria e Bashkuar Britanike; Deklaratën e datës 27.09.2017 nga [redacted] Shkresë më titull Paraprintimi e ndëshkuar nga ankuesi; Kërkesë për dokumentet të gjendjes civile e datës 27.09.2017 Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 27.09.2017 nga [redacted] Zarin e datës 16.08.2022;

Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 16.09.2022; Akt Emërimin AE.Nr.01-112/02-37385 të datës 13.12.2021 për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës për Zyrtar të Gjendjes Civile; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me numër 01-116/01-16405 të datës 28.06.2022; Njoftimin e datës 23.06.2022 nga inspektorati i Agjencisë së Regjistrimit Civil; Regjistri nga libri Amës për _____ i datës 26.12.1998; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 27.07.2022; Shkresë për Udhëheqësin e Sektorit të Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Vendimi me Numër 01-116/02-19210 i datës 29.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës është i kundërligjshëm sepse nuk kam bërë asnjë shkelje lidhur me atë që më është iniciuar procedura disiplinore dhe komisioni disiplinor nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat e lëndës, bazën juridike dhe gjendjen faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe ligjshmërinë e Vendimit me Numër 01-116/02-19210 të datës 29.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës, ka konstatuar që në bazë të këtij vendimi konstatohet që Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës, në seancës disiplinore më datë 21.07.2022 ka ftuar iniciuesin e procedurës disiplinore por edhe ankuesin, mirëpo që këtë e ka bërë në takime të ndara, ndërsa dispozita ligjore përkon me atë që në seancë disiplinore njëkohësisht duhet me qenë të dyja palët në mënyrë që të ballafaqojnë argumentet e tyre, siç parashihet me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, në këtë rast Kolegji, vlerëson se janë bërë shkelje procedurale, sepse iniciuesi i procedurës disiplinore dhe pala ndaj të cilët është iniciuar procedura disiplinore ftohen në seancë të njëjtë.

Po ashtu Kolegji gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankuesit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës përveç që ka shqyrtuar masën disiplinore ndaj ankuesit si në dispozitiv të tij, në arsyetim i'u është referuar kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore procesverbaleve të seancës disiplinore dhe administrimit të provave, nuk ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete përmes të të cilave do të vërtetohej se cilat janë shkeljet ka bërë ankuesit dhe cilat veprime ka ndërmarr ankuesi, kështu që ka qenë i obliguar të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Numër 01-116/02-19210 i datës 29.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës është kundërtëhënëse dhe i paarsyetuar siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme



Administrative ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoj se Vendimi me Numër 01-116/02-19210 i datës 29.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni Disiplinor është i obliguar në që të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe në ri procedurë të mënjanojë shkelje procedurale, dhe të shqyrtoj rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marr parasysh të gjitha rrethanat e rastin si dhe duke marr parasysh edhe nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda.A.nr.713/2022, datë 14/10/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;